



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 19.12.2022

Nr: 25

Ora: 12:30

**VENDIM**

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 12, NR.13, NR. 14  
DHE PEZULLIMIN E SHQYRTIMIT**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 19.12.2022, me pjesëmarrjen e:

<b>Ledio Braho</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli Bele</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

<b>KËRKUES:</b>	<b>1. Mati TV</b>
	<b>2. Club Tv</b>
	<b>3. Shoqëria "G2 Media"</b>

**OBJEKT:** Kundërshtim i vendimit nr. 224, datë 07.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Mbi miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve publike të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.04.2021".

**BAZA LIGJORE:**

Nenet 21, 123/1, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

**VËREN:**

Pas daljes së vendimit nr. 224 datë 07.12.2022 “Mbi miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve publike të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.04.2021”, përkatësisht pikës 45 të tij, për marrjen e masës administrative me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) TV Mati, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor, OSHMA Mat TV ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 12 regj., datë 12.12.2022.

Në mbledhjen e datës 19.12.2022, ora 12:30, pas relatimit të z. Ledio Braho u konstatua se kërkesa ankimore nr. 12 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

Në referim të këtij vendimi, pika 26, për marrjen e masës administrative me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Club TV , sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor, OSHMA “Club TV” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 13 regj., datë 12.12.2022.

Në mbledhjen e datës 19.12.2022, ore 12:30, pas relatimit të z. Ilirjan Rusmali, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 13 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

Kundër vendimit nr. 224, datë 07.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, pika 60, për marrjen e masës administrative me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) A2 CNN, sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor, Shoqëria “G2 Media” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 14 regj., datë 13.12.2022.

Në mbledhjen e datës 19.12.2022, ore 12:30, pas relatimit të z. Ledio Braho, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 14 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

Duke qenë se në vendimin nr. 224 datë 07.12.2022 të KSHZ preken interesat e ligjshme për disa OSHMA dhe se afati i ankimit për këtë vendim është 30 ditë dhe mund të ketë dhe kërkesa ankimore nga subjekte të tjera, KAS vlerëson se duhet pezulluar shqyrtimi me objektin e sipërcituar derisa të përfundojë afati i ankimit 30 ditë për të gjitha OSHMA-të dhe më pas të shqyrtohet në një vendim të vetëm. Në zbatim të nenit 19, pika 1, të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, përcaktohet se, *KAS përpara ose gjatë shqyrtimit të një ankimi administrativ, vendos shqyrtimin bashkërisht të tij me një ose më shumë ankime të tjera, të paraqitura nga subjekte të ndryshme kundër të njëjtit vendim...”*.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b” dhe “dh” , 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

## V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesave ankimore nr. 12, datë 12.12.2022, të paraqitur nga OSHMA Mat TV, nr. 13, datë 12.12.2022 nga OSHMA Club TV dhe nr. 14, datë 13.12.2022 nga OSHMA shoqëria “G2 Media”;
2. Pezullimin e shqyrtimit administrativ deri në përfundim të afatit të ankimit 30 ditor ndaj vendimit nr. 224, datë 14.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Ky vendimi është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

**Ledio BRAHO** - **Relator**

**Elvin LAKO** - **Anëtar**

**Elvis ÇEFA** - **Anëtar**

**Ilirjan RUSMALI** - **Anëtar**

**Koli BELE** - **Anëtar**